



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
KOMISIONI I KONKURENCËS

**VENDIM**

Nr.300, datë 06.12.2013

**“Për  
një ndryshim në Vendimin nr. 291, datë 18.11.2013 “Mbi hapjen e procedurës se  
hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të  
konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet e transportit për  
përgjegjësitë ndaj palëve të treta”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar
Iva	ZAJMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.12.2013, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me procedurën e hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.

**Baza ligjore:** - Neni 24, shkronja d); neni 43, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar);  
- Ligji Nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Pasi mori në shqyrtim relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me procedurën e hetimit në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit police sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta,

**VËREN SE:**

1. Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr. 291, datë 18.11.2013 ka hapur procedurën e hetimit në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta për periudhën nga 1 nëntori 2013 deri në përfundim të procedurave hetimore.
2. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, ngriti Grupin e Punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi.

3. Për realizimin e kësaj procedure nga Grupi i Punës është kërkuar informacion nga institucione dhe ndërmarrje të ndryshme që disponojnë informacion të nevojshëm për hetimin. Ky informacion nuk ka ardhur akoma në mënyrë të plotë pranë Autoritetit të Konkurrencës.

4. Komisioni i Konkurrencës çmon se sigurimi i një informacioni të plotë dhe të detajuar, për të parë më mirë sjelljen e ndërmarrjeve në treg është i nevojshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 43, pika 1, të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i procedurave administrative”,

### **VENDOSI:**

1. Në Vendimin nr. 291, datë 18.11.2013 “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”, pika “III”, të ndryshohet si vijon:

*“III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo me vonë se data 17 Janar 2014.”*

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Koço BROKA**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Iva ZAJMI**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Rezana KONOMI**

(\_\_\_\_\_)

**Zv. Kryetar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**